

1 E martë, 10 maj 2022

2 [Paraqitje e mëtejshme]

3 [Seancë e hapur]

4 [I akuzuari merr pjesë përmes videolidhjes]

5 --- Fillon në orën 15.15

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Mirë se erdhët të gjithë,  
7 në sallën e gjyqit dhe jashtë saj.

8 Znj. Sekretare, ju lutem mund të paraqisni lëndën.

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëdita. Kjo është  
10 çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i Specializuar kundër Hashim  
11 Thaçit, Rexhep Selimit, Jakup Krasniqit dhe Kadri Veselit.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ju lutem atëherë palëve të  
13 paraqiten.

14 Fillojmë me Zyrën e Prokurorit të Specializuar.

15 Z. TIEGER: [Përkthim] Mirëdita të gjithëve brenda dhe  
16 jashtë sallës së gjyqit. Unë jam Alan Tieger dhe Lies van  
17 Welde përfaqësojmë Zyrën e Prokurorit të Specializuar.

18 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

19 Atëherë Mbrojtja. Shikoj z. Young.

20 Z. YOUNG: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Unë jam David  
21 Young dhe ndihmohem nga z. Roberts dhe dr. Jasini.  
22 Përfaqësojmë z. Rexhep Selimi.

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

24 Avokatja e Viktimave.

25 ZNJ. RADZIEJOWSKA: [Përkthim] Unë jam znj. Radziejowska,

1 përfaqësuese e viktimave në këtë çështje.

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Për procesverbalin vërej që  
3 z. Rexhep Selimi e ndjek seancën me anë të videolidhjes.

4 Z. Nilsson.

5 Z. NILSSON: [Përkthim] Unë jam Jonas Nilsson nga Seksioni  
6 i Shërbimeve Gjyqësore.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Me tre shtator 2021, ZPS-ja  
8 dorëzoi një kërkesë për ndryshimin e aktakuzës në pajtim me  
9 rregullën 90(1)(b). ZPS-ja paraqiti tre kategori ndryshimesh.

10 Kategoria e parë përfshin dy qendra ndalimi në komunën e  
11 Suharekës ku -- ose në lidhje me të cilat anëtarët të UÇK-së  
12 kryen akte të përndjekjes, burgosjes, ndalimit arbitrar, akte  
13 të tjera çnjerëzore, trajtim mizor, akte të torturës, vrasjes  
14 së paligjshme dhe zhdukjes me forcë.

15 Kategoria e dytë përbëhej nga dy incidente të përndjekjes  
16 dhe vrasjes së paligjshme të kryera në lidhje me qendrën e  
17 ndalimit në komunën e Gjilanit me një ndryshim për kuadrin  
18 kohor për qendrën e ndalimit në Gjilan.

19 Kategoria e tretë përfshinte dy incidente të pjesëmarrjes  
20 personale të të akuzuarve në krimeve të paraqitura në  
21 aktakuzë.

22 Me 23 dhjetor 2021, unë nxora një vendimin të parë mbi  
23 kërkesën e ZPS-së me të cilin miratova kërkesën e ZPS-së për  
24 ndryshimin e aktakuzës, në lidhje me kategorinë e tretë të  
25 ndryshimeve të propozuara të cilat unë i gjykova se nuk

1 përbënin akuza të reja.

2           Më tej, konstatova që kategoria e parë dhe e dytë e  
3 ndryshimeve ishin akuza të reja dhe duhej të vlerësoheshin në  
4 pajtim me standardin e kërkuar të dyshimit të bazuar mirë,  
5 sikurse përcaktohet në rregullën 86(4) e Rregullores, bazuar  
6 në provat e paraqitura në përputhje me rregullën 86(3) të  
7 Rregullores.

8           Palët u urdhëruan që të parashtrojnë përgjigjet dhe  
9 kundërpërgjigjet e tyre në lidhje me pyetjen nëse materiali  
10 mbështetës i ndryshimeve që konsideroheshin se përbënin akuza  
11 të reja e mbështeste konstatimin për ekzistencën e dyshimit të  
12 bazuar mirë sipas rregullës 86(4).

13           Më 22 prill 2022, konfirmova kategorinë e parë dhe të  
14 dytë të akuzave -- të ndryshimeve në akuzat dhe përmbajtjen e  
15 tyre. Gjithashtu urdhërova ZPS-në që deri të premtën më 29  
16 prill 2022, të dorëzonin një aktakuzë të ndryshuar me  
17 kategorinë e parë dhe të dytë të ndryshimeve.

18           Me 29 prill 202, ZPS-ja dorëzoi aktakuzën e ndryshuar,  
19 një version konfidencial me më pak redaktime dhe versionin  
20 publik të redaktuar të përmbledhjes së provave të kategorisë  
21 së parë dhe versionin konfidencial dhe version publik të  
22 redaktuar të përmbledhjes së provave të kategorisë së dytë të  
23 ndryshuar.

24           Me 2 maj 2022, caktova datën për këtë seancë apo  
25 paraqitje -- për paraqitje vijuese.

1 Tani më lejoni të shpjegoj qëllimin konkret të kësaj  
2 paraqitjeje vijuese për të akuzuarin edhe personat që na  
3 ndjekin në sallën e gjyqit dhe në internet.

4 Seanca e sonte nuk është gjykim, nuk do të paraqiten as  
5 do të debatohen prova po kështu nuk do të diskutohet apo të  
6 merret vendim lidhur me fajësinë apo pafajësinë e të  
7 akuzuarit.

8 Qëllimi i kësaj paraqitjeje vijuese përcaktohet në nenin  
9 39 të Ligjit dhe rregullat 90 dhe 92 të Rregullores. Sipas  
10 këtyre dispozitave, si Gjykatës unë duhet të siguroj që të  
11 akuzuarit t'i lexohen akuzat e reja në aktakuzën e ndryshuar  
12 të konfirmuar; të konfirmoj se i akuzuari i kupton ato akuza  
13 të reja; të bindem se janë respektuar të drejtat e të  
14 akuzuarit në veçanti e drejta e tij për të pasur mbrojtës; dhe  
15 të informoj të akuzuarin se brenda 30 ditësh nga seanca e  
16 sotme ai do të ftohet të vetëdeklarohet fajtor ose i pafajshëm  
17 lidhur me secilën pikë të re të aktakuzës së ndryshuar të  
18 konfirmuar.

19 Nëse i akuzuar dëshiron ai mund ta bëjë vetëdeklarimin  
20 menjëherë për fajësi apo pafajësi.

21 Pres nga palët që t'u përmbahen këtyre aspekteve që do  
22 t'i trajtoj një nga një.

23 Së pari, z. Selimi, a mund t'ju pyes nëse -- të  
24 konfirmoni nëse e keni marrë aktakuzën e konfirmuar të  
25 ndryshuar të datës 29 prill 2022?

1 I AKUZUARI REXHEPI: [Përmes videolidhjes] Po, e kam marrë  
2 aktakuzën dhe e kam lexuar në tërësi.

3 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Selimi.

4 Tani do t'i kërkoj Sekretares që të lexojë akuzat e reja  
5 në aktakuzën e re të ndryshuar të konfirmuar.

6 ZNJ. Sekretare keni fjalën

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim]

8 1. Në aktakuzën e ndryshuar të konfirmuar Prokurori i  
9 Specializuar shton akuzat e reja në vijim kundër z. Selimi:

10 a. Në lidhje me krimet që pretendohet të jenë kryer në  
11 Budakovë, në Semetishtë në komunën e Suharekës midis afërisht  
12 4 korrikut 1998 dhe shtatorit 1998 dhe më 28 ose 29 prill 1999  
13 ose rreth këtyre datave në lidhje me të paktën 12 persona:

14 i. Pika 1: Krimi kundër njerëzimit i përndjekjes i  
15 ndëshkueshëm në bazë të nenit 13(1)(h) të Ligjit;

16 ii. Pika 2: Krimi kundër njerëzimit i burgosjes i  
17 ndëshkueshëm bazë të nenit 13(1)(e) e Ligjit;

18 iii. Pika 3: Krimi i luftës i ndalimit arbitrat i  
19 ndëshkueshëm në bazë të nenit 14(1)(c) të Ligjit;

20 iv. Pika 4: Krimi kundër njerëzimit i akteve të tjera  
21 çnjerëzore i ndëshkueshëm në bazë të nenit 13(1)(j) të Ligjit;

22 v. Pika 5: Krimi i luftës i trajtimit mizor i ndëshkueshëm  
23 në bazë të nenit 14(1)(c)(i) të Ligjit;

24 vi. Pika 6: Krimi kundër njerëzimit i torturës i  
25 ndëshkueshëm në bazë të nenit 13(1)(f) të Ligjit;

1 vii. Pika 7: Krimi i luftës i torturës ndëshkueshëm në  
2 bazë të nenit 14(1)(c)(i) të Ligjit;

3 viii. Pika 8: Krimi kundër njerëzimit i vrasjes së  
4 paligjshme i ndëshkueshëm në bazë të nenit 13(1)(a) të Ligjit;

5 ix. Pika 9: Krimi i luftës së vrasjes së paligjshme i  
6 ndëshkueshëm në bazë të nenit 14(1)(c)(i) të Ligjit; dhe

7 x. Pika 10: Krimi kundër njerëzimit i zhdukjes me forcë  
8 të personave i ndëshkueshëm në bazë të nenit 13(1)(i) të  
9 Ligjit;

10 b. Në lidhje me krimet që pretendohet se janë kryer në  
11 Gjilan, në komunën e Gjilanit përsëri në korrik të vitit 1999  
12 në lidhje me të paktën 3 persona:

13 i. Pika 1: Krimi kundër njerëzimit i përndjekjes i  
14 ndëshkueshëm në bazë të nenit 13(1)(h) të Ligjit;

15 ii. Pika 2: Krimi kundër njerëzimit i burgosjes i  
16 ndëshkueshëm në bazë të nenit 13(1)(e) të Ligjit;

17 iii. Pika 3: Krimi i luftës i ndalimit arbitrar i  
18 ndëshkueshëm në bazë të nenit 14(1)(c) të Ligjit;

19 iv. Pika 4: Krimi kundër njerëzimit i akteve të tjera  
20 çnjerëzore i ndëshkueshëm në bazë të nenit 13(1)(j) të Ligjit;

21 v. Pika 5: Krimi i luftës i trajtimit mizor i  
22 ndëshkueshëm në bazë të nenit 14(1)(c)(i) të Ligjit;

23 vi. Pika 6: Krimi kundër njerëzimit i torturës i  
24 ndëshkueshëm në bazë të nenit 13(1)(f) të Ligjit;

25 vii. Pika 7: Krimi i luftës i torturës i ndëshkueshëm në

1 bazë të nenit 14(1)(c)(i) të Ligjit;

2 viii. Pika 8; Krimi kundër njerëzimit i vrasjes së  
3 paligjshme i ndëshkueshëm në bazë të nenit 13(1)(a) të Ligjit;  
4 dhe

5 ix. Pika 9: Krimi i luftës i vrasjes së paligjshme i  
6 ndëshkueshëm në bazë të nenit 14(1)(c)(i) të Ligjit.

7 2. Krimet në pikat 1, 2, 4, 6, 8 dhe 10 u kryen si pjesë  
8 e sulmit gjerësisht të përhapur ose sistematik kundër  
9 popullatës civile në Kosovë dhe në Shqipërinë veriore, së paku  
10 që prej marsit 1998 deri në shtator 1999. Në veçanti, këto  
11 krime vunë në shënjestër kundërshtarët që konsideroheshin se  
12 kishin qenë bashkëpunëtorë ose të lidhur me forca zyrtarë ose  
13 institucione shtetërore të Republikës Federative të  
14 Jugosllavisë ("RFJ") ose ndryshe nuk mbështetnin qëllimet ose  
15 metodat e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ("UÇK") dhe më vonë  
16 të Qeverisë së Përkohshme të Kosovë, ndër të cilët personat të  
17 lidhur me Lidhjen Demokratike të Kosovës dhe persona që ishin  
18 serbë, romë dhe persona të kombësive të tjera.

19 3. Krimet në pikat 3, 5, 7 dhe 9 u kryen kundër personave  
20 që nuk merrnin pjesë aktive në luftime në kontekstin e  
21 konfliktit të armatosur jondërkombëtar dhe në lidhje me këtë  
22 konflikt në Kosovë ndërmjet UÇK-së dhe forcave të RFJ-së dhe  
23 të Republikës së Serbisë, ndër të cilat njësite të ushtrisë  
24 jugosllave, njësite policore dhe njësite të tjera të  
25 Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe grupe të tjera që

1 luftonin në emër të RFJ-së dhe Serbisë së paku afërisht që nga  
2 marsi 1998 deri afërsisht 16 shtator 1999.

3 4. Në lidhje me këto krime ekziston një dyshim i bazuar  
4 mirë se z. Selimi ka përgjegjësi penale në bazë të nenit  
5 16(1)(a) të Ligjit:

6 a. Kryerjen si anëtar i ndërmarrjes kriminale të  
7 përbashkët të krimeve në pikat 1-10 ose si alternativë për  
8 kryerjen si anëtar i ndërmarrjes kriminale të përbashkët  
9 të sipërpërmendur për krimet në pikat 1-10, duke pasur  
10 dijeni se krime të tilla mund të kryheshin në zbatim të  
11 qëllimit të përbashkët të ndërmarrjes kriminale të  
12 përbashkët dhe duke e marrë përsipër atë rrezik me vullnet  
13 të lirë; dhe/ose

14 b. Mdhmën dhe inkurajimin e krimeve në pikat 1-10.

15 5. Gjithashtu, dhe si alternativë ekziston dyshimi i  
16 bazuar mirë se z. Selimi ka përgjegjësi penale si epror në  
17 bazë të nenit 16(1)(c) të Ligjit për krimet në pikat 1-10.

18 Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, znj.

20 Sekretare.

21 Z. Selimi, dua t'ju kujtoj se sot nuk është dita për të  
22 kundërshtuar akuzat, por thjesht për të pranuar se i keni  
23 kuptuar akuzat, se çfarë thuhet në to. Do të keni mundësi të  
24 bollshme t'i kundërshtoni akuzat me ndihmën e mbrojtësit tuaj.

25 Z. Selimi i kuptuat akuzat e reja që janë përfshirë në



1 aktakuzën e konfirmuar që i lexoi Sekretarja?

2 I AKUZUARI SELIMI: [Përmes videolidhjes] Natyrisht që i  
3 kam lexuar dhe i kam kuptuar dhe pohoj edhe një herë se nuk  
4 kam të bëj asgjë me krimet dhe as me akuzat e prezantuara në  
5 këtë aktakuzë.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Selimi.

7 Z. Young më duket sikur kërkuat fjalën.

8 Z. YOUNG: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Vetëm sa për  
9 t'ju thënë që për neve që po e ndjekim seancën nga interneti  
10 nganjëherë ngec figura dhe pamja dhe unë kam bindjen e plotë  
11 që z. Selimi i kupton plotësisht akuzat që bëhen dhe atë e  
12 bëri të qartë, kështu që nuk ka nevojë që të përsëriten edhe  
13 një herë. Megjithatë siç e thashë ka pasur disa ngecje të  
14 pamjes të figurës dhe të zërit.

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Selimi, por  
16 në qoftë se dëshironi këto mund të lesohen edhe një herë nga  
17 Sekretarja, por transkripti i kësaj seance do të jetë i  
18 disponueshëm në internet dhe mund të shikohet aty.

19 Atëherë, z. Selimi t'ju informoj për të drejtat tuaja  
20 përpara kësaj Gjykate.

21 Ligji për Dhomat e Specializuara dhe Rregullorja e  
22 Procedurës dhe e Provave ju garantojnë një numër të drejtash  
23 por unë do t'ju lexoj disa prej më të rëndësishmeve.

24 Së pari ju do të prezumoheni i pafajshëm derisa të  
25 vërtetohet fajësia përtej dyshimit të arsyeshëm. Në kuadër të

1 marrjes së vendimit për akuzat kundër jush, ju keni të drejtën  
2 e një gjykimi të drejtë dhe publik në vartësi të masave që  
3 mund të urdhërohen për Mbrojtjen e dëshmitarëve dhe viktimave.

4 Keni të drejtën që të informoheni menjëherë dhe në hollësi  
5 në një gjuhë që e kuptoni për natyrën dhe shkakun e akuzave  
6 kundër jush.

7 Keni të drejtën të keni kohë dhe mjete të mjaftueshme për  
8 të përgatitur Mbrojtja tuaj dhe të komunikoni me mbrojtësin që  
9 e keni zgjedhur vetë.

10 Keni të drejtën që të gjykoheni brenda një kohe të  
11 arsyeshme.

12 Keni të drejtën të gjykoni në praninë tuaj dhe të mbroheni  
13 përmes avokatit.

14 Keni të drejtën që t'ju caktohet mbrojtës dhe pa pagesë,  
15 në qoftë se s'keni mjete të mjaftueshme për ta paguar.

16 Keni të drejtën të bëni pyetje ose dikush tjetër t'i bëjë  
17 pyetje në emrin tuaj dëshmitarëve që paraqiten kundër jush dhe  
18 të kërkoni paraqitjen dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve.

19 Keni të drejtën e ndihmës pa pagesë të një përkthyesi në  
20 qoftë se nuk e kuptoni gjuhën që flitet në gjykatë.

21 Keni të drejtën që të mos detyroheni të dëshmoni kundër  
22 vetes dhe të pranoni fajësinë.

23 Keni të drejtën të qëndroni i heshtur dhe nuk do të  
24 nxirret asnjë përfundim negativ nga heshtja juaj.

25 Po kështu keni të drejtën të bëni deklaratë jo nën betim

1 në çështjen tuaj dhe të paraqiteni si dëshmitar nën betim.

2 Keni të drejtën të bëni mocione paraprake.

3 Keni të drejtën të merrni materialin mbështetës të  
4 aktakuzës të ndryshuar që është dorëzuar për konfirmim.

5 Keni të drejtën të merrni të gjitha deklaratat e  
6 dëshmitarëve që Prokurori i Specializuar ka ndërmend t'i  
7 thërrasë për të dëshmuar në gjyq, në një gjuhë që e kuptoni  
8 dhe flisni, pra në gjuhën shqipe.

9 Keni të drejtën të merrni menjëherë çfarëdo informacioni  
10 që mund të sugjerojë në mënyrë atë arsyeshme pafajësinë tuaj  
11 ose të lehtësojë fajësinë ose që ndikon në besueshmërinë dhe  
12 mbështetshmërinë e provave të Prokurorit të Specializuar, sapo  
13 ky informacion të jetë në ruajtje nën kontrollin apo dijeninë e  
14 tyre.

15 Keni të drejtën t'u vihen në dispozicion të gjitha  
16 materialet, të gjitha provat apo faktet relevante që disponon  
17 Prokurori i Specializuar përpara dhe gjatë gjykimit.

18 Kjo e drejtë është objekt i vetëm atyre kufizime që janë  
19 rreptësisht të nevojshme dhe kur zbatohen masa mbrojtëse  
20 kompensuese.

21 Keni të drejtë që të mos mbaheni në paraburgim për një  
22 periudhë të paarsyeshme para hapjes së çështjes gjyqësore.

23 Të kërkonit rishikimin e vendimit të paraburgimit dhe t'i  
24 apeloni këto vendime në Gjykatën e Apelit.

25 Keni të drejtën që ose drejtpërsëdrejti ose përmes

1 procesit të kërkimit të lejes për apel, të kërkoni të bëni  
2 apel.

3 Z. Selimi, ju i dëgjuat të drejtat më të rëndësishme që  
4 gëzoni në përputhje me kornizën ligjore të Dhomave të  
5 Specializuara. A i kuptoni këto të drejta?

6 I AKUZUARI SELIMI: Po, i kuptoj.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Selimi.

8 Dua t'ju informoj se sipas nenit 21(5) të Ligjit nuk mund  
9 të përfaqësoni vetë sepse jeni në paraburgim kështu që  
10 përfaqësuesi nga mbrojtësi është i detyrueshëm.

11 Vërej që ju jeni i përfaqësuar si tani dhe ashtu dhe më  
12 parë dhe jam i bindur rrjedhimisht që i akuzuari është i  
13 përfaqësuar nga mbrojtës.

14 Tani do t'i kthehem mundësisë që i akuzuari të  
15 vetëdeklarohet nëse dëshiron në përputhje me rregullën 92.

16 Z. Selimi brenda 30 ditëve nga dita e sotme do t'ju  
17 kërkohet të vetëdeklaroheni ose të -- për fajësi ose pafajësi  
18 për secilën akuzë të re në aktakuzë.

19 Në qoftë se dëshironi këtë mund ta bëni menjëherë, pra të  
20 pranoni fajësinë ose të thoni që jeni i pafajshëm, të  
21 vetëdeklaroheni i pafajshëm.

22 Pra, z. Selimi dua t'ju pyes nëse keni pasur mundësinë t'i  
23 diskutoni akuzat në aktakuzën me mbrojtësin tuaj dhe nëse jeni  
24 i gatshëm që të vetëdeklaroheni sot?

25 I AKUZUARI SELIMI: I nderuar Gjykatës më lejoni të

1 deklarohe m i pafajshëm siç edhe në të gjitha pika të tjera të  
2 aktakuzës.

3 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] faleminderit z. Selimi.

4 E shënuam.

5 Atëherë do t'i kërkoj palëve nëse kanë ndonjë çështje  
6 tjetër që duan ta ngrenë.

7 Z. TIEGER: [Përkthim] Jo, s'kemi asgjë tjetër për të  
8 ngritur asnjë çështje tjetër.

9 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Mbrojtësja e Viktimave?

10 ZNJ. RADZIEJOWSKA: Jo s'kemi asgjë.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Atëherë z. Young për  
12 Mbrojtjen.

13 Z. YOUNG: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Në këtë fazë  
14 nuk kemi asgjë tjetër për të shtuar.

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Young. Me  
16 kaq mbyllet seanca e sotme. Falënderoj të gjithë  
17 pjesëmarrësit, përkthyesit, stenografët, teknikët dhe  
18 personelin e sigurisë.

19 Me kaq mbyllet seanca.

20 --- Paraqitja e Mëtejshme përfundon në orën

21 15.36

22

23

24

25